




PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS

Prishtinë, qershor 2015



PRIORITETET E BANORËVE TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS

Ky publikim është pjesë e projektit Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente, që implementohet nga Advocacy Training and Resource Center-ATRC dhe financohet nga Olof Palme International Center, me mbështetje të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e këtij publikimi reflekton pikëpamjet e autorit dhe jo domosdoshmërisht të Olof Palme International Center.

Prishtinë, qershor 2015

PËRBERJA

RRETH ATRC	6
RRETH PROJEKTIT	7
1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E NOVOBËRDËS.....	8
1.1 Popullsia	8
1.2 Arsimi	8
1.3 Ekonomia	8
1.4 Shërbimet publike	8
1.5 Historia	9
1.6 Kalaja	10
1.7 Mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal	10
2. PRIORITETET E BANORËVE	11
2.1 Prioritetet e përgjithshme të banorëve të Komunës së Novobërdës	11
2.2 Prioritetet e femrave të Komunës së Novobërdës	12
2.3 Prioritetet e përfaqësuesve të Këshillave Lokale	12
3. QYTETI I NOVOBËRDËS.....	13
3.1 Pasqyra e përgjithshme.....	13
3.2 Rekomandimet e banorëve:.....	13
4. FSHATI LLABJAN	15
4.1 Pasqyra e përgjithshme.....	15
4.2 Rekomandimet e banorëve.....	15
5. FSHATI BOQEVISHT	16
5.1 Pasqyra e përgjithshme.....	16
5.2 Rekomandimet e banorëve:.....	16
6. FSHATI PREKOC	17
6.1 Pasqyra e përgjithshme.....	17

6.2 Rekomandimet e banorëve:.....	18
7. FSHATI BOSTAN.....	18
7.1 Pasqyra e përgjithshme.....	18
7.2 Rekomandimet e banorëve:.....	19
8. FSHATI KOZNICË	19
8.1 Pasqyra e përgjithshme.....	19
8.2 Rekomandimet e banorëve:.....	20
9. FSHATI VLLASALI	20
9.1 Pasqyra e përgjithshme.....	20
9.2 Rekomandimet e banorëve:.....	21
10. FSHATI ZEBINCË.....	21
10.1 Pasqyra e përgjithshme.....	21
10.2 Rekomandimet e banorëve:.....	21
11. FSHATI IZVOR	22
11.1 Pasqyra e përgjithshme.....	22
11.2 Rekomandimet e banorëve:.....	23
12. FSHATI MANISHINCË	23
12.1 Pasqyra e përgjithshme.....	23
12.2 Rekomandimet e banorëve:.....	23
13. FSHATI QYLKOVÇ.....	23
13.1 Pasqyra e përgjithshme.....	23
13.2 Rekomandimet e banorëve:.....	24
14. FSHATI TERNIQEVÇ.....	24
14.1 Pasqyra e përgjithshme.....	24
14.2 Rekomandimet e banorëve:.....	24

15. FSHATI STANISHOR I EPËRM	25
15.1 Pasqyra e përgjithshme.....	25
15.2 Rekomandimet e banorëve:.....	26
16. FSHATI KOSAQË.....	27
16.1 Pasqyra e përgjithshme.....	27
16.2 Rekomandimet e banorëve:.....	27
17. FSHATI STRAZHË.....	27
17.1 Pasqyra e përgjithshme.....	27
17.2 Rekomandimet e banorëve:.....	28
18. FSHATI STANISHOR I POSHTËM	28
18.1 Pasqyra e përgjithshme.....	28
18.2 Rekomandimet e banorëve:.....	28
19. FSHATI JASENOVIK	29
19.1 Pasqyra e përgjithshme.....	29
19.2 Rekomandimet e banorëve:.....	30
20. FSHATI KLLIBUKARE	31
20.1 Pasqyra e përgjithshme.....	31
20.2 Rekomandimet e banorëve:.....	31
21. FSHATI TULLAR.....	31
21.1 Pasqyra e përgjithshme.....	31
21.2 Rekomandimet e banorëve:.....	32
22. FSHATI PARALLOVË	33
22.1 Pasqyra e përgjithshme.....	33
22.2 Rekomandimet e banorëve:.....	33
23. FSHATI KORETISHT	33

23.1 Pasqyra e përgjithshme.....	33
23.2 Rekomandimet e banorëve:.....	33
24. FSHATI PASJAK	34
24.1 Pasqyra e përgjithshme.....	34
24.2 Rekomandimet e banorëve:.....	35
25. FSHATRAT MAKRESH I ULËT DHE DRAGANC.....	36
25.1 Pasqyra e përgjithshme.....	36
25.2 Rekomandimet e banorëve:.....	36
26. FSHATI KUFCË E EPËRME	37
26.1 Pasqyra e përgjithshme.....	37
26.2 Rekomandimet e banorëve:.....	37
27. FSHATRAT BUSHINCË, TIRINCË DHE MIGANOVÇ.....	38
27.1 Pasqyra e përgjithshme.....	38
27.2 Rekomandimet e banorëve:.....	38
28. FSHATI MAKRESH I EPËRM.....	39
28.1 Pasqyra e përgjithshme.....	39
28.2 Rekomandimet e banorëve:.....	39
29. FSHATRAT BOLEVÇ DHE CAREVÇ	39
29.1 Pasqyra e përgjithshme.....	39
29.2 Rekomandimet e banorëve:.....	40

RRETH ATRC

Advocacy Training and Resource Center - ATRC është organizatë kosovare jo-fitimprurëse, e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, si parakusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngritë kapacitetin e OJQ-ve dhe iniciativave qytetare që të ndërmarrin kampanja avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse që i takojnë standardeve ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativave qytetare, administratës publike, institucioneve politike, mediave, etj, pavarësisht nga bindjet dhe përkatësitë politike, fetare, etnike, etj.

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, ATRC ka ndihmuar numër të madh të OJQ-ve në Kosovë duke synuar ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimin në punën e tyre, krijimin dhe artikullimin e kërkesave të tyre dhe pajisjen me aftësi avokuese në strukturat e qeverisë në lidhje me çështjet që preokupojnë shoqërinë kosovare.

ATRC realizon qëllimet e veta përmes katër programeve kryesore të saj:

1. Programi i ngritjes së kapaciteteve, i cili synon që përmes trajnimeve dhe ofrimit të konsulencave, të rrisë kapacitetet e organizatave joqeveritare në Kosovë në fushën e zhvillimit organizativ, menaxhimit të projekteve dhe në avokim.
2. Programi i administrimit të Granteve, i cili synon të ndihmojë organizatat joqeveritare lokale, përmes granteve kryesisht në avokim.
3. Programi për Avokim, përmes projekteve të ndryshme ATRC synon të avokoj në institucione nacionale dhe lokale për probleme të ndryshme të cilat janë preokupim dhe brengë e qytetarëve në përgjithësi.
4. Informimi, me të cilin ATRC synon të ofroj informacione në mënyrë elektronike, përmes informacioneve të freskëta në ueb faqe, diskutime publike dhe tryeza të rrumbullakëta, ndërtim koalicioni, ndërmjetësim partneriteti dhe bashkëpunimi. ATRC, gjithashtu ofron librari me botime për çështjet sociale, politike dhe ekonomike që lidhen me Kosovën dhe rajonin.

RRETH PROJEKTIT

Advocacy Training and Resource Center - ATRC me mbështetje financiare nga The Olof Palme International Center nga janari i vitit 2012 ka filluar së implementuari projektin “Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente”. Projekti ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, në komunën e Novobërdës, Gjiçanit, Kamenicës dhe Vitisë.

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në mes ATRC dhe Komunave të lartpërmendura ATRC ka zhvilluar një sërë aktiviteteve të përqendruara në ngritjen e kapaciteteve avokuese të qytetarëve në iniciimin e praktikave të qëndrueshme dhe efektive në mes qytetarëve dhe komunave të tyre. Gjatë vitit 2014 ATRC ka inicuar themelimin e Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje në katër komunat e lartpërmendura.

Publikimi “Prioritetet e banorëve të Komunës së Novobërdës” është rezultat i takimeve që ATRC, në bashkëpunim të ngushtë me Komunën dhe anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve ka zhvilluar me përfaqësuesit e Këshillave Lokale si dhe qytetarë.

Përmes aktiviteteve që realizohen në kuadër të këtij projekti ATRC synon që të rris bashkëpunimin në mes Komunave dhe qytetarëve; t’u ofroj mundësinë qytetarëve që të shprehin lirshëm kërkesat dhe rekomandimet e tyre dhe të ushtrojnë presionin demokratik në institucionet lokale për marrjen në konsideratë të kërkesave të tyre gjatë hartimit të planeve komunale dhe njëkohësisht t’i ndihmoj Komunës në procesin e hartimit të buxhetit komunal, duke i ofruar të dhëna konkrete për secilin fshat veç e veç.

ATRC gjatë këtij viti do të vazhdoj me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në mes zyrtarëve komunal dhe qytetarëve, në mënyrë që rekomandimet e qytetarëve të paraqitura në këtë dokument të merren parasysh.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR KOMUNËN E NOVOBËRDËS

Novobërda është Komunë me popullatë të përzier Shqiptare, Serbe, Turke dhe Rome. Është në lindje të Kosovës dhe kufizohet në Veri me Prishtinën, në Perendim me Lipjanin, në Jug me Gjilanin dhe në Lindje me Kamenicën. Një pjesë e rrugës magjistrale Prishtinë-Gjilan, e përshkon komunën e Novobërdës në fshatin Llabjan. Novobërda lidhet edhe me dy rrugë të tjera me Gjilanin dhe me një rrugë të rendit të dytë me Kamenicën. Terreni i komunës është kryesisht kodrinoro-malor, me një lartësi prej 1246 m. Komuna e Novobërdës ka kushte ideale për zhvillimin e turizmit dimëror.

Investimet e bëra në komunën e Novobërdës janë përqëndruar kryesisht në rregullimin e infrastrukturës rrugore, rregullimin e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Megjithatë, akoma disa lagje brenda qytetit si dhe shumë fshatra ballafaqohen me mungesë rrjetit të ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit dhe asfaltimit të rrugëve.

1.1 Popullsia

Komuna e Novobërdës ka rreth 9670 banorë. Prej tyre rreth 60% janë serb, 39% shqiptarë dhe 1% rom. Komuna e Novobërdës ka rreth 1,500 persona nën moshën 30 vjeçare. Megjithatë, papunësia mbetet një nga sfidat kryesore me të cilën ballafaqohen banorët e Komunës së Novobërdës.

1.2 Arsimi

Komuna e Novobërdës ka 5 shkolla zyrtare, 6 institucione paralele dhe një shkollë e mesme ekonomike në fshatin Bostan. Mungesa e drejtimeve të tjera për arsimim të mesëm shkakton një problem shumë të madh për nxënësit në komunën e Novobërdës. Shumë prej nxënësve duhet të udhëtojnë në komunat e tjera për të vazhduar arsimin e mëtutjeshëm, kryesisht në Prishtinë ose Gjilan. Në tri shkolla fillore me nga dy klasë mësojnë fëmijë të komunitetit serb dhe rom, kurse shkolla në Prekoc ka një klasë për fëmijët parashkollorë. Nxënësit e komunitetit serb dhe rom ndjekin sistemin paralel shkollor.

1.3 Ekonomia

Të ardhurat në këtë komunë vijnë nga puna me autoritetet publike, prej sistemit të arsimit, prej shërbimeve shëndetësore ose FSK. Gjithashtu, shumë banorë merren me bujqësi dhe me biznese të vogla.

1.4 Shërbimet publike

Shëndetësia-Komuna e Novobërdës ka një Shtëpi të shëndetit, që ndodhet në Novobërdë si dhe pesë qendra shëndetësore në fshatrat Llabjan, Prekoc, Jasenovik, Kufcë dhe Koretisht. Vetëm në Shtëpinë e shëndetit ofrohen shërbime shëndetësore gjatë 24 orëve, kurse në Qendrat shëndetësore në këtë komunë shërbimet shëndetësore ofrohen vetëm gjatë tetë orëve në ditë.

Patrimi dhe grumbullimi i mbeturinave- Në komunën e Novobërdës bëhet pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave. Megjithatë, në disa lagje Ekohigjiena ka ndërprerë për një kohë

ofrimin e këtij shërbimi, për shkak të mospagesës së qytetarëve për këtë shërbim. Gjatë takimit të organizuar nga ATRC me kryetarët e Këshillave lokale përfaqësuesi i Ekohigjienës ka kërkuar nga ta bashkëpunim në kryerjen e pagesave nga qytetarët, në mënyrë që pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave të bëhet në gjithë territorin e komunës së Novobërdës.

1.5 Historia

Duke u bazuar në burime të shumta historike territori i komunës së Novobërdës ka qenë një trevë e populluar qysh në zhvillimet e hershme të njerëzimit. Novobërda posaçërisht bëhet qendër e rëndësishme në mesjetë atëherë kur edhe merr hov zhvillimi i xehtarisë.

Sipas disa shënimeve në shekullin e XV Novobërda kishte 45,000 banorë. Kulminacionin e zhvillimit ekonomik dhe politik e arrin me zhvillimin e minierës së Novobërdës, e cila ishte shumë e pasur me minerale të arit, argjendit, plumbit dhe zinkut. Sipas disa të dhënave të asaj kohe, në vitin 1450 Miniera e Novobërdës prodhonte afër 6000 kg argjend në vit. Pasuritë e minierës, e cila ishte më e njohur në Europën e asaj kohe u shfrytëzuan nga perandoritë e ndryshme duke filluar nga ajo romake, bizantine dhe osmane. Në atë kohë Novobërda kishte edhe fabrikën e vet të monedhave dhe të stolive nga ari dhe argjendi.

Këto periudha të ekzistencës së qytetit kanë lënë gjurmë të shumta arkeologjike. Për këtë shkak, në vitin 1994 Instituti i Monumenteve dhe Muzeut rajonal të Prishtinës me qëllim të mbrojtjes së monumenteve të Novobërdës ka bërë përkufizim topografik të shtrirjes së qytetit mesjetar dhe lokaliteteve arkeologjike përreth tij, me ç'rast pos kalasë mesjetare janë përfshirë vendbanime të tjera, objekte kulti, objekte fetare, varreza, furra për shkrirjen e xeheve etj, në një sipërfaqe prej afro 130 hektarësh. Në sipërfaqen prej 130 ha dhe në afërsi të kalasë nuk lejohet kurrfarë ndërtimi si dhe gjurmime pa lejen e KK.

1.6 Kalaja



Pa dyshim, qendra simbolike dhe gjeografike e këtij rajoni është pika më e njohur e referimit që e përkufizon atë. Rrënojat mbresëlënëse të kalasë mesjetare Kalaja qëndrojnë lart në maje të malit të Novobërdës dhe zënë vend të madh në historinë e Evropës dhe si një objekt trashëgimie nën mbrojtje të UNESCO-s. Për fat të keq, lënia pas dore e ka dëmtuar shumë tokën rreth kështjellës. Ky objekt i rëndësishëm historik kërkon vëmendje urgjente për të parandaluar shkatërrimin e mëtejshme dhe për të përmirësuar objektet e vizitorëve. Në bashkëpunim me organet e tjera zyrtare dhe agjencitë shtetërore, Komuna duhet të përgadis një plan ruajtjeje për restaurimin e Kalasë dhe zonës përreth.

1.7 Mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal

Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal më 15 korrik, të vitit 2008 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 2008/8 “Për Marrëveshjet e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane”. Bazuar në këtë udhëzim administrativ, në prill të vitit 2012 Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka aprovuar rregulloren për Organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Novobërdës. Kjo rregullore ka për qëllim të rregulloj mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit në mes komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshilla lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Në bazë të kësaj rregulloreje Komuna e Novobërdës, gjatë vitit 2013, ka themeluar 25 Këshilla lokale.

Në vitin 2014 Komuna e Novobërdës ka themeluar Komitetin konsultativ të qytetarëve, bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Novobërdës dhe Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna. Vendimi për themelimin e Komitetit Konsultativ të qytetarëve është marrë nga Kuvendi i Komunës së Novobërdës, pas paraqitjes së kërkesës nga ATRC për themelimin e këtij komiteti.



Pjesëmarrja e ATRC në mbledhjen e Kuvendit për prezantimin e kërkesës për themelimin e Komitetit konsultativ të qytetarëve

2. PRIORITETET E BANORËVE

ATRC ka identifikuar nevojat dhe rekomandimet e qytetarëve të të gjitha fshatrave të komunës së Novobërdës si dhe lagjeve brenda qytetit. Prioritetet e banorëve janë identifikuar nga ATRC, në bashkëpunim me komunën e Novobërdës dhe Komitetin Konsultativ të qytetarëve, gjatë takimeve të zhvilluara me përfaqësues të Këshillave lokale dhe qytetarë.

2.1 Prioritetet e përgjithshme të banorëve të Komunës së Novobërdës

- Të investohet në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.
- Të asfaltohet rruga regjionale që lidh Komunën e Novobërdës me Komunën e Gjilanit.
- Të investohet në zhvillimin e turizmit.
- Të mos implementohen projektet vetëm në një lagje apo një pjesë të fshatit, por të përfshijnë gjithë fshatin.
- Të ngriten kapacitetet e banorëve, përmes trajnimeve dhe aktiviteteve tjera të ngjashme, për zhvillimin e turizmit rural dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

- Të ofrohen shërbime shëndetësore gjatë 24 orëve, në qendrat shëndetësore në fshatrat Llabjan, Prekoc, Jasenovik, Kufcë dhe Koretisht. Këto qendra shëndetësore janë të hapura vetëm gjatë tetë orëve në ditë. Gjithashtu, të ofrohen edhe shërbime të tjera shëndetësore, pasi në ambulanta punon vetëm mjeku i përgjithshëm.
- Të menaxhohet me rrjetin e ujësjellësit.
- Të zhvendoset në ndonjë pjesë tjetër tregu i kafshëve. Tregu i kafshëve është në Llabjan dhe të dielave bllokohet rruga kryesore.

2.2 Prioritetet e femrave të Komunës së Novobërdës

- Të ndërtohet një mini fabrikë, për prodhimin dhe ambalazhimin e produkteve vendore. Në Jasenovik është objekti, në të cilin më herët ka funksionuar fabrika e tekstit dhe i cili do të mund të shfrytëzohej për këtë qëllim.
- Të përkrahet zhvillimi i bujqësisë dhe bizneseve të vogla.
- Të përfshihen femrat në pozitat dhe proceset vendimmarrëse në nivel lokal.
- Të ndërtohet një çerdhe për fëmijë në Novobërdë ose në Llabjan.
- Të ngriten kapacitetet e femrave për zhvillimin e turizmit rural.

2.3 Prioritetet e përfaqësuesve të Këshillave Lokale

- Të jenë të informuar përfaqësuesit e fshatrave për projektet që implementohen në lokalitetet e tyre. Në këtë mënyrë do të mund të monitorohej më mirë implementimi i projekteve.
- Të rritet bashkëpunimi i Komunës me Këshillat lokale.



Përfaqësuesit e Këshillave lokale dhe anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve gjatë identifikimit të nevojave të qytetarëve

3. QYTETI I NOVOBËRDËS

3.1 Pasqyra e përgjithshme

Qyteti i Novobërdës ka 4 lagje: Kolonia e vjetër, Kolonia e re, lagja Mehmetaj dhe lagja Pllavicë, në të cilat jetojnë rreth 150 familje. Qyteti i Novobërdës ka një rrugë kryesore, e cila i lidh jo vetëm lagjet e Novobërdës, por edhe Kalanë dhe Minierën. Banorët theksojnë problemin e mosmirëmbajtjes së kësaj rruge, e cila është përgjegjësi e nivelit qëndror. Gjithashtu, trotuari në këtë rrugë është ndërtuar vetëm në një pjesë, duke mos përfshirë pjesën tjetër të rrugës në lagjen Mehmetaj dhe në lagjen Kolonia e re. Mungesa e trotuarit në këto dy lagje paraqet rrezik në veçanti për nxënësit, të cilët shkojnë në shkollë përgjatë kësaj rruge.

Qyteti i Novobërdës është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit, por furnizimi me ujë nuk është i mjaftueshëm. Problemet me mosfurnizimin e mjaftueshëm me ujë kanë të bëjnë me mosmbulimin e shpenzimeve nga banorët. Për shkak të numrit të vogël të banorëve që bëjnë pagesën, qytetarët nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet për furnizimin me ujë. Gjithashtu, shumica e banorëve nuk janë të paisur me njësorë të ujit si dhe ka shumë obligime të mëparshme të papaguara nga banorët. Mungesa e furnizimit me ujë, ka bërë që shumica e banorëve të katër lagjeve të largohen nga vendbanimet e tyre.

Qyteti i Novobërdës është i lidhur me rrjetin e kanalizimit. Megjithatë, rrjeti i kanalizimit në disa pjesë të qytetit është shumë i vjetër dhe paraqet problem për banorët.

Në qytet janë dy shkolla fillore, të cilat i plotësojnë kushtet për zhvillimin e mësimi. Megjithatë, banorët nuk janë të kënaqur me punimet, të cilat janë bërë disa vite më parë, në rregullimin e fushës së sportit. Në qytetin e Novobërdës është ndërtuar shkolla e mesme, e cila ka qenë edhe një nga prioritetet e banorëve të identifikuar gjatë vitit 2013. Qyteti i Novobërdës ka një Shtëpi të shëndetit, në të cilën ofrohen shërbime shëndetësore për të gjithë banorët e komunës së Novobërdës.

Problemi tjetër, i ngritur nga banorët, është edhe mos implementimi i projekteve si duhet. Sipas tyre, ky problem ka të bëjë me mungesën e monitorimit gjatë implementimit të projekteve. Para disa vitesh është ndërtuar trotuari në lagjen Pllavicë, i cili nuk është monitoruar nga askush dhe nuk është realizuar mirë. Gjithashtu, nga projektet e fundit është vendosja e kubëzave në qendër, të cilat gjithashtu nuk janë punuar mirë. Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve nga ana e Komunës si dhe përfshirja e qytetarëve në këtë proces, sipas banorëve, do të mundësonte implementimin më me sukses të projekteve.

3.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të zgjidhet çështja e furnizimit me ujë.
- Të përfshihen përfaqësuesit e fshatit dhe qytetarët në monitorimin e çdo projekti që implementohet në fshat, që nga faza fillestare dhe deri në përfundim të tij.

- Të vendoset rrjeti i kanalizimit edhe në disa pjesë të qytetit. Rrjeti i kanalizimit është shumë i vjetër dhe paraqet problem për banorët.
- Të sigurohen linja transporti Novobërdë – Prishtinë dhe Novobërdë - Gjilan
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të bëhet vazhdimi i trotuarit në lagjen Mehmetaj dhe në Koloninë e re. Mungesa e trotuarit në këto dy lagje paraqet rrezik në veçanti për nxënësit, të cilët shkojnë në shkollë; Të bëhet asfaltimi në të dy pjesët e rrugës për Pllavicë.
- Të përkrahen banorët në zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe pemtarisë.
- Të renovohet dhe të funksionalizohet Shtëpia e Kulturës.
- Të funksionalizohet dhe të vazhdohet ndriçimi publik në lagjet e mbetura.
- Të sigurohet mjeku kujdestar në Qendrën Familjare Mjekësore edhe për 16 orë.
- Të rregullohet fusha sportive.
- Të rregullohen kulmet e disa shtëpive në lagjen Kolonia e vjetër.
- Të bëhet sigurimi i oxhakëve të minierës së vjetër.
- Të rregullohen ndërtesat publike në Koloninë e re dhe të vjetër.



Përfaqësuesit e Këshillave lokale dhe anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve gjatë identifikimit të nevojave të qytetarëve

4. FSHATI LLABJAN

4.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Llabjan ka 10 lagje, me rreth 2000 banorë. Infrastruktura rrugore në fshatin Llabjan është e mirë. Komuna ka investuar në rregullimin e rrugëve dhe vetëm një nga rrugët e fshatit nuk është e asfaltuar. Megjithatë, mosrregullimi i kësaj rruge paraqet problem mjaft të madh për banorët. Kjo rrugë ka filluar të rregullohet në vitin 2009, por deri më tani akoma nuk ka përfunduar. Banorët i janë drejtuar disa herë Komunës me kërkesë që kjo rrugë të asfaltohet. Gjatësia e kësaj rruge është 700-800 metra dhe lidhet me rrugën Digellaj-Sallkovit.

Veç rrugëve, komuna gjithashtu ka investuar në rregullimin e rrjetit elektrik, rrjetit të ujësjellësit si dhe renovimin e shkollës. Rrjeti i kanalizimit është rregulluar në disa lagje të fshatit, por dy nga lagjet e fshatit, lagja e Re dhe Istrefaj, nuk janë të lidhura me këtë rrjet. Mungesa e rrjetit të kanalizimit në këto dy lagje paraqet rrezik për banorët, pasi ujërat e zeza derdhen në ambient të hapur.

Gjendja më e keqe në fshatin Llabjan është në Lagjen e Re, ku 16 shtëpi veç mosasfaltimit të rrugës dhe mungesës së trotuarit, nuk janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Mungesa e trotuarit në Lagjen e Re rrezikon në veçanti nxënësit, të cilët shkojnë në shkollë. Për problemet dhe gjendjen e vështirë në këtë lagje banorët kanë paraqitur disa kërkesa në komunë.

Problem tjetër i ngritur nga banorët është edhe mungesa e ujit në shkollë. Shkolla në Llabjan për 12 vite ballafaqohet me problemin e ujit. Uji në këtë shkollë sigurohet me ramje të lirë, mirëpo për shkak të keqpërdorimeve të shumta shkolla ka mungesë të ujit.

Në fshatin Llabjan në përgjithësi bëhet pastrimi dhe grumbullimi i mbeturinave. Megjithatë, në lagjen Sallkaj komuna ka ndërprerë për një kohë ofrimin e këtij shërbimi. Arsyeja e ndërprerjes së këtij shërbimi nga Komuna është bërë për shkak të mos pagesës së qytetarëve për këtë shërbim. Ndërkohë, sipas banorëve pjesa më e madhe e tyre jetojnë me ndihmë sociale dhe nuk kanë mundësi të paguajnë për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave.

4.2 Rekomandimet e banorëve

- Të përfshihen përfaqësuesit e fshatit dhe qytetarët në monitorimin e çdo projekti që implementohet në fshat, që nga faza fillestare dhe deri në përfundim të tij.
- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit, rrjeti i ujësjellësit, rruga dhe trotuari për 16 shtëpi në Lagjen e re të fshatit Llabjan.
- Të rregullohet uji në shkollë.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të asfaltohet rruga Digellaj-Sallkovit; Të vazhdohet me ndërtimin e trotuarit prej Pompës deri te Lagja e re; Të pastrohen të gjitha kanalet e rrugëve.

- Të bëhet vazhdimi i shtyllave elektike në Lagjen e Re.
- Të vendoset ndriçimi publik.
- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit në lagjet e reja.
- Të vendoset rrethoja te varrezat e vjetra.
- Të ndërrohet vendi i tregut të kafshëve.

5. FSHATI BOQEVISHT

5.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Boqevisht gjendet në perendim të komunës së Novobërdës, në kufirin në mes të komunës së Gjilanit dhe komunës së Lipjanit. Fshati numron gjithsej gjashtë ekonomi familjare.

Në këtë vendbanim Komuna e Novobërdës para disa vitesh ka investuar në asfaltimin e rrugës kryesore, me gjatësi prej 4 km, vendosjen e rrjetit të ujësjellësit dhe rregullimin e rrethojës së varrezave të fshatit. Gjithashtu, është zgjidhur një nga problemet kryesore të banorëve rreth menaxhimit të rrjetit të ujësjellësit. Megjithatë, në fshat nuk është zgjidhur problemi tjetër i rëndësishëm, ai i rrjetit të kanalizimit, i cili akoma mbetet një nga prioritetet e banorëve.

5.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në fshat.
- Të rregullohen shtyllat elektrike të tensionit të ulët.
- Të investohet në sektorin e bujqësisë.
- Të monitorohet nga komuna çdo investim i bërë. Në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet me sukses duhet të mundësohet përfshirja e qytetarëve në këtë proces.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Novobërdës dhe anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve në punëtorinë e mbajtur nga ATRC

6. FSHATI PREKOC

6.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Prekoc ka 5 lagje, në të cilat jetojnë rreth 300 banorë. Banorët e fshatit Prekoc ballafaqohen me probleme të shumta. Ndër problemet kryesore banorët veçojnë infrastrukturën jo të mirë rrugore. Komuna ka bërë asfaltimin e rrugës deri te shkolla, që ka qenë edhe një prej prioriteteve të banorëve të identifikuar nga ATRC, në bashkëpunim me Komunën dhe Këshillat lokale gjatë vitit 2013, megjithatë ka ende shumë rrugë të paasfaltuara. Ndër to është rruga prej rreth 600 metra në lagjen Zabel, e cila kishte filluar të rregullohet dhe akoma nuk ka përfunduar. Kjo rrugë do të duhej të asfaltohej deri në lagjen Cukës, me gjatësi prej 1 km e gjysmë.

Problem tjetër i ngritur nga banorët është edhe mungesa e rrjetit të kanalizimit në lagjen Zabicë, ndërkohë që në lagjen e re ku nuk jeton asnjë banorë, para disa vitesh, është rregulluar rrjeti i

kanalizimit. Ndër problemet tjera të banorëve të fshatit Prekoc janë edhe mungesa e ndriçimit publik, kapaciteti i dobët i energjisë elektrike, etj.

Si dhe në fshatrat tjerë të Komunës së Novobërdës, banorët e fshatit Prekoc kërkojnë që të jenë të përfshirë në procesin e implementimit të projekteve, që nga faza fillestare dhe deri në finalizimin e tyre.

6.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të investohet në infrastrukturën rrugore: Të përfundohet rruga rreth 1 km e gjysmë, nga lagja Zabel deri te lagja e Cukës; Të asfaltohet rruga me gjatësi 2 km., për lagjen Tiringani; Të asfaltohet rruga me gjatësi 3 km., në lagjen Zelovi.
- Të rregullohet ndriçimi publik në disa në lagje.
- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit në lagjen Zabicë.
- Të mbulohet tereni sportiv, për shkak se dëmtohet gjatë stinës së dimrit.
- Të përkrahen banorët në fushën e bujqësisë dhe të bletarisë.

7. FSHATI BOSTAN

7.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Bostan ka 40 shtëpi me rreth 250 banorë, të komunitetit serb dhe rom. Komuna e Novobërdës ka bërë investime në fshatin Bostan, si në rregullimin e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, rregullimin e fushës së sportit, etj. Gjithashtu, Komuna ka bërë asfaltimin e një rruge të fshatit, që ka qenë një nga kërkesat e qytetarëve të paraqitura në vitin 2013 megjithatë, në lagjen e romëve nuk është asfaltuar rruga 100m., si dhe dy rrugë lokale.

Në fshatin Bostan kalon rruga regjionale që lidh Komunën e Novobërdës me Komunën e Gjilanit. Kjo rrugë, e cila është me gjatësi rreth 1 km., është përgjegjësi e nivelit qendror dhe banorët shprehen se janë të rrezikuar nga automjetet, pasi mungojnë shenjat e komunikacionit.

Gjatë vitit të kaluar Komuna ka marrë parasysh edhe njërin nga rekomandimet e qytetarëve, të paraqitura në vitin 2013, për rrënimin e objektit të shkollës së vjetër. Pas largimit të këtij objekti në atë hapsirë është ndërtuar një çerdhe për fëmijë. Kërkesa tjetër e qytetarëve për rregullimin e murit të një shtëpie, që ndodhet në rrugën që lidh fshatin Bostan me fshatrat tjerë gjithashtu është rregulluar nga Komuna. Megjithatë, banorët shprehen se ky mur do të duhej të ndërtohej më i lartë.

Investim tjetër i bërë nga Komuna gjatë vitit të kaluar në këtë fshat është edhe rregullimi i fushës së sportit të mbuluar.

7.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të asfaltohet rruga në lagjen e romëve, me gjatësi 100 m., si dhe dy rrugë lokale.
- Të lidhet me rrjetin e kanalizimit një shtëpi.
- Të bëhet asfaltimi i rrugës Bostan-Kala.
- Të vendosen shenjat e komunikacionit në rrugën që lidh Komunën e Novobërdës me Komunën e Gjilanit, e që kalon në fshatin Bostan.
- Të ndërrohen shtyllave elektrike në disa pjesë.



Përfaqësuesit e Këshillave lokale dhe anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve gjatë identifikimit të nevojave të qytetarëve

8. FSHATI KOZNICË


8.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Koznicë ka 30 shtëpi me rreth 200 banorë. Komuna e Novobërdës ka bërë disa investime në fshatin Koznicë, të cilat janë përqëndruar në rregullimin e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Megjithatë, rrjeti i ujësjellësit nuk është funksional. Gjithashtu, kohët e fundit Komuna ka bërë asfaltimin e rrugës në fshat prej 1.7 km, që ka qenë një nga prioritetet e banorëve të paraqitura në viti 2013.

Megjithatë, problem për banorët e fshatit Koznicë paraqet mosvazhdimi i rregullimit të rrugës dhe trotuarit. Kjo rrugë, e cila është shumë e ngushtë, është pranë shkollës dhe paraqet rrezik për nxënësit. Gjithashtu, rrjeti elektrik në fshat paraqet rrezik për banorët, sepse është shumë i vjetër.

8.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vihet në funksion rrjeti i ujësjellësit.
- Të investohet në infrastrukturën rrugore në fshat: Të asfaltohet rruga në fshat; Të rregullohet trotuari, ndërtimi i të cilit është i domosdoshëm, sepse rruga e cila ndodhet pranë shkollës është shumë e ngushtë dhe paraqet rrezik për nxënësit; Të bëhet rregullimi i rrugës Koznicë-Sferaqak; Të asfaltohet rruga tek varrezat.
- Të ndërtohen 3-5 shtëpi të banorëve të fshatit, të cilat janë në gjendje shumë të keqe.
- Të mbyllet gropa, e cila ka mbetur e hapur gjatë rregullimit të rrugëve. Kjo gropë paraqet rrezik për fëmijët dhe kafshët, në veçanti gjatë reshjeve kur mbushet me ujë.
- Të renovohet Parku i lodrave për fëmijë.
- Të rregullohet rrjeti elektrik. Rrjeti elektrik është shumë i vjetër dhe paraqet rrezik për banorët.
- Të vendoset rrethoja e oborrit të shkollës.



Kryesuesi dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës së Novobërdës në punëtorinë e mbajtur nga ATRC

9. FSHATI VLLASALI

9.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Vllasali ka tri lagje: Vllasali, Bunjak dhe Kalaja. Infrastruktura rrugore në këtë fshat është pjesërisht e mirë, pasi shumë nga rrugët nuk janë të asfaltuara.

Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit është vendosur në lagjet Vllasali dhe Kalaja, kurse lagja Bunjak nuk është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Megjithatë, edhe pse dy lagje janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit ndër problemet kryesore të banorëve është mungesa e menaxhimit adekuat të rrjetit të ujësjellësit. Deri më tani me këtë çështje është marrë komuna,

pasi nuk ka kompani publike e cila do të mirrej me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit.

9.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të gjindet zgjidhja për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit.
- Të monitorohet nga komuna çdo investim i bërë dhe të përfshihen qytetarët në këtë proces.
- Të investohet në infrastrukturën rrugore: Të asfaltohen rrugët në lagjet: Behxhetaj, Tahiraj, Salihaj, Brahimaj dhe Islamaj; Të asfaltohet rruga Kala-Minierë; Të rregullohet rruga Vllasali-Izvor; Të bëhet hapja e rrugës Vllasali-Marec; Të rregullohen rrugët për këmbësorë në Kala; Të bëhet rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në lagjet Vllasali, Bunjak dhe Kala; Të rregullohen trotuaret.
- Të investohet në objekte banimi, me qëllim të zhvillimit të turizmit rural.
- Të rregullohen shtyllat elektrike të tensionit të ulët.
- Të investohet në sektorin e bujqësisë.
- Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit, rrjeti i kanalizimit dhe rrjeti elektrik të Bunjakët.
- Të vendoset ndriçimi në lagjet Vllasali dhe Bunjak.

10. FSHATI ZEBINCË

10.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Zebincë ka 9 lagje, në të cilat jetojnë 150 banorë. Infrastruktura rrugore në fshatin Zebincë nuk është e mirë. Vetëm një nga rrugët e fshatit është e asfaltuar, kurse rrugët lokale nuk janë të rregulluara. Gjithashtu, fshati Zebincë nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Fshati ka një shkollë fillore, megjithatë në shkollë nuk ka ujë.

10.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Të rregullohet uji në shkollë dhe në Shtëpinë e kulturës.
- Të rregullohen rrugët e lagjeve.
- Të vendoset ndriçimi në disa prej lagjeve.
- Të asfaltohet rruga kryesore që kalon në këtë fshat.
- Të investohet në sektorin e bujqësisë.



Anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve të Komunës së Novobërdës në punëtorinë e mbajtur nga ATRC

11. FSHATI IZVOR

11.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Izvor ka 7 lagje, në të cilat jetojnë mbi 300 banorë. Infrastruktura rrugore në fshat është pjesërisht e mirë. Në Izvor është asfaltuar gjysma e rrugës, mirëpo banorët kërkojnë që të vazhdohet me asfaltimin e rrugës. Gjithashtu, është e paasfaltuar rruga që lidh fshatin Izvor me dy fshatra dhe një rrugë lokale.

Ndër problemet kryesore të banorëve është mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit të fshat.

11.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të rregullohet uji në shkollë. Shkolla ka ujë, por uji nuk mund të përdoret për pije.
- Të investohet në infrastrukturën rrugore: Të asfaltohen dy rrugët dhe një tjetër rrugë e shkurtër në një lagje.
- Të rregullohet rrjeti elektrik, i cili është shumë i vjetër.

12. FSHATI MANISHINCË

12.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Manishincë ka 3 lagje, në të cilat jetojnë rreth 80 banorë. Infrastruktura rrugore në fshat nuk është e mirë. Një pjesë e rrugës kryesore në fshat është asfaltuar para disa vitesh, mirëpo rreth 1 km. e kësaj rruge ka mbetur pa përfunduar. Në fshat gjithashtu nuk janë të rregulluara rrugët lokale.

Mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe rrjetit të kanalizimit janë ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohen banorët e fshatit Manishincë.

12.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të përfundohet asfaltimi i rrugës rreth 1 km dhe të rregullohen rrugët tjera në fshat.
- Të rregullohen shtëpitë e disa banorëve.

13. FSHATI QYLKOVÇ

13.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Qylkovc ka 3 lagje, me rreth 83 banorë. Infrastruktura rrugore në fshatin Qylkovc është e mirë, pasi Komuna e Novobërdës ka investuar në rregullimin e rrugës kryesore të fshatit deri në mes të lagjeve. Megjithatë, kjo rrugë nuk ka përfunduar dhe ka mbetur pa u asfaltuar pjesa tjetër e rrugës, prej mesit të lagjeve në drejtim të fshatit Kllobukar.

Komuna gjithashtu, ka investuar në vendosjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit në disa lagje të fshatit. Veç rregullimit të rrugëve, rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit Komuna ka investuar edhe në rregullimin e rrjetit elektrik dhe rregullimin e disa objekteve të banimit.

13.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit në lagjet tjera.
- Të rregullohet asfaltimi i rrugës në vazhdim.
- Të ndërtohen objekte të tjera të banimit.
- Të rregullohen shtyllat elektrike të tensionit të ulët.
- Të vendoset ndriçimi publik.

14. FSHATI TERNIQEV

14.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Terniqev ndodhet buzë rrugës Novobërdë - Gjilan. Fshati është i ndarë në dy lagje: pjesa e epërme e fshatit dhe pjesa e poshtme (Todorci). Problemi kryesor i banorëve të fshatit është mungesa e menaxhimit adekuat të rrjetit të ujësjellësit.

14.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të gjindet zgjidhja për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit.
- Të asfaltohet i rrugës në lagjen Todorci, te pjesa e poshtme e fshatit.
- Të rregullohen shtyllat elektrike të tensionit të ulët.
- Të investohet në sektorin e bujqësisë.



Anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve të Komunës së Novobërdës në punëtorinë e mbajtur nga ATRC

15. FSHATI STANISHOR I EPËRM

15.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Stanishor ka 30 shtëpi, në të cilat jetojnë rreth 210 banorë. Komuna para dy vitesh ka investuar në vendosjen e rrjetit të kanalizimit në fshat, që ka qenë edhe një prej kërkesave të banorëve të paraqitura në vitin 2013. Megjithatë, banorët ballafaqohen me probleme të shumta, duke filluar nga mungesa e rrjetit të ujësjellësit, mungesa e një çerdheje për fëmijë dhe në veçanti moskryerja si duhet dhe sipas planit e projekteve që realizohen në fshat. Rruga kryesore në fshat është asfaltuar para një viti, por nuk është punuar mirë dhe nuk janë vendosur pusetat. Për më tepër kjo rrugë është prishur menjëherë. Gjithashtu, sipas banorëve, rruga është planifikuar të asfaltohet me gjatësi 4 km, por janë asfaltuar vetëm 3 km. Për këtë shkak përfaqësuesit e Këshillit lokal kërkojnë që komuna t'i informoj ata rreth projekteve që implementohet dhe njëkohësisht të mundësohet monitorimi i projekteve, në mënyrë që projektet të implementohen ashtu si janë planifikuar.

Fshati ka një shkollë, e cila është rregulluar gjatë vitit të kaluar. Rregullimi i shkollës ka qenë një nga kërkesat e banorëve të paraqitura në vitin 2013. Sipas banorëve shkolla është rregulluar mire, por shprehin pakënaqësi për largimin e këndit të lodrave nga ajo pjesë.

15.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshat.
- Të rregullohet rruga kryesore, e cila është dëmtuar menjëherë pas asfaltimit.
- Të sigurohet transporti më i shpeshtë për nxënësit. Transporti për nxënësit sigurohet vetëm një herë në ditë.
- Të ndërtohet një çerdhe për fëmijë.
- Të vendoset ndriçimi publik.



Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit në takim me ATRC

16. FSHATI KOSAQË

16.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Kosaqë ka dy lagje, në të cilla jetojnë 400 banorë. Ky fshat nga Komuna e Gjilanit ka kaluar në administrimin e Komunës së Novobërdës. Gjendja e përgjithshme në fshat nuk është e mirë dhe në mungesë të kushteve banorët kanë filluar të shpërngulen nga fshati.

Komuna para afro dy vitesh ka investuar në rregullimin e rrjetit të ujësjellësit, që ka qenë edhe një prej kërkesave të banorëve të identifikuar nga ATRC gjatë vitit 2013. Megjithatë, problem për banorët paraqet mosasfaltimi i rrugës dhe mungesa e rrjetit të kanalizimit. Rruga kryesore kishte filluar të asfaltohet para disa vitesh nga Komuna e Gjilanit, por nuk kishte përfunduar. Për më tepër kjo rrugë është dëmtuar akoma më shumë. Mosasfaltimi i rrugës paraqet problem të madh për banorët dhe sipas tyre kjo rrugë është vështirë e kalueshme sidomos gjatë stinës së dimrit.

Fshati Kosaqë nuk ka shkollë, megjithatë Komuna e Novobërdës ka siguruar transportin për nxënësit, të cilët udhëtojnë 6 km, për të vijuar mësimin në fshatin Prelepnice të Komunës së Gjilanit.

16.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të asfaltohet rruga kryesore.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të ndërtohet shkolla në fshat.
- Të vendoset rrethoja e varrezave.
- Të rregullohet fusha e sportit.

17. FSHATI STRAZHË

17.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Strazhë ka 10 lagje, në të cilat jetojnë 332 banorë. Gjendja e përgjithshme në fshat nuk është e mirë. Banorët ballafaqohen me probleme të shumta dhe sipas tyre investimet nga komuna janë bërë në fshatrat tjerë dhe kanë munguar në këtë fshat. Deri më tani të vetmin investim që ka bërë Komuna në fshatin Strazhë është rregullimi i një pjesë e shkurtër e rrugës dhe renovimi i shkollës fillore, i cili është bërë shumë vite më parë.

Ndër problemet kryesore banorët theksojnë mungesën e furnizimit me ujë, pasi fshati nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Gjithashtu, asnjë nga 10 lagjet e fshatit nuk janë të lidhura me rrjetin e kanalizimit. Problem i madh në këtë fshat është edhe numri i madh i banorëve të papunësuar.

Përfaqësuesit e fshatit Strazhë kanë shprehur gatishmërinë e tyre që të bashkëpunojnë me Komunën e Novobërdës dhe të japin kontributin e tyre në drejtim të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

17.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të rregullohet infrastruktura rrugore.

18. FSHATI STANISHOR I POSHTËM

18.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Stanishor ka mbi 80 shtëpi, në të cilat jetojnë mbi 200 banorë. Pas procesit të decentralizimit, fshati Stanishor ka kaluar në administrimin e Komunës së Novobërdës. Derisa distanca nga fshati deri në Komunën e Gjilanit është 3 km, distanca nga fshati deri në Komunën e Novobërdës është 20 km. Në këtë mënyrë banorëve iu është vështirësuar komunikimi me komunën.

Një nga problemet kryesore në fshatin Stanishor është mungesa e rrjetit të ujësjellësit. Fshati është i lidhur me rrjetin e kanalizimit, megjithatë banorët janë të pakënaqur me punimet që janë bërë në këtë rrjet.

Dëmtimi i pyjeve është gjithashtu problem i ngritur nga banorët e fshatit Stanishor. Sipas tyre dëmtimi i pyjeve ka qenë gjithmonë prezent, por që askush nuk është marrë me parandalimin e këtij problemi.

18.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në fshat.
- Të bëhen përmirësime në rrjetin e kanalizimit.



Kryetari, nënkryetari, Kryesuesi i Kuvendit dhe anëtarët e kuvendit të komunës së Novobërdës në takim me ATRC

19. FSHATI JASENOVIK

19.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Jasenovik ka 10 lagje, në të cilat jetojnë 400 banorë. Në fshatin Jasenovik ka probleme të shumta, me ç'rast banorët dhe në veçanti të rinjtë ndihen të lënë anash nga institucionet komunale.

Problem kryesor i banorëve është papunësia dhe shumica e banorëve jetojnë me ndihmë sociale. Infrastruktura rrugore në fshat nuk është e mirë. Në veçanti rruga kryesore në fshatin Jasenovik është në gjendje të keqe dhe vështirë e kalueshme gjatë reshjeve. Kurse, në dy lagje të fshatit, në Petroviç dhe Llaushicë, para disa vitesh është punuar në rregullimin e rrugës, por ato nuk janë punuar si duhet dhe janë dëmtuar.

Banorët janë të pakënaqur edhe me mungesën e rrjetit të ujësjellësit. Vetëm një lagje e fshatit është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, ndonëse edhe ky rrjet nuk është punuar mirë. Fshati gjithashtu, nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit.

Problem tjetër i ngritur nga banorët është rrjeti elektrik i vjetër, me ç'rast ka pasur edhe mungesë të energjisë elektrike në shkollë për dy muaj. Mungesa e energjisë elektrike në shkollë ka shkaktuar edhe mungesë të nxemjes.

19.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në gjithë fshatin.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të investohet në asfaltimin e rrugëve.
- Të mundësohet një linjë transporti për Graçanicë.
- Të ndërtohet një sallë sportive për të rinjtë. Kjo sallë do të mund të përdorej nga të rinjtë e tri fshatrave përreth.
- Të ndërtohet çerdhja e fëmijëve në fshat.
- Të krijohen vende pune për banorët.
- Të investohet në rregullimin e rrjetit elektrik, pasi shtyllat janë shumë të vjetra.



Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Novobërdës gjatë punëtorisë së mbajtur nga ATRC

20. FSHATI KLLOBUKARE

20.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Klobukarë është i ndarë në shtatë lagje: Barin, Dosliq, Kosmotant, Sharen, Kaqar, Qeranovic dhe Islamaj. Problemi kryesor i banorëve të fshatit është mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm dhe mungesa e rrjetit të kanalizimit.

Në këtë fshat komuna ka investuar në vendosjen e rrethojës së varrezave, rregullimin e rrugës dhe rregullimin e ujësjellësit për disa lagje si dhe ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në disa pjesë të fshatit.

20.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të gjindet zgjidhja për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit.
- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit në lagjet që nuk janë përfshirë në këtë projekt.
- Të bëhet asfaltimi i rrugëve lokale në lagje.
- Të vendoset rrethoja e varrezave tjera në fshat.
- Të rregullohen shtyllat elektrike të tensionit të ulët.
- Të investohet në sektorin e bujqësisë.

21. FSHATI TULLAR

21.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Tullar ka 3 lagje, në të cilat jetojnë 200 banorë. Problemet e banorëve të fshatit Tullar janë të mëdha. Ndër problemet kryesore të banorëve është papunësia, me ç'rast shumica e banorëve jetojnë me ndihmë sociale. Gjendja e vështirë ekonomiko-sociale e banorëve ka çuar edhe deri te shpërngulja e tyre, parandalimin e së cilës banorët e shohin vetëm përmes investimeve që mund të bëhen në sektorin e bujqësisë.

Një tjetër problem i banorëve është mungesa e rrjetit të kanalizimit. Kurse, sa i përket rrjetit të ujësjellësit, ka probleme rreth menaxhimit të tij. Fshati ka një shkollë katër vjeçare dhe për të vazhduar shkollimin nxënësit udhëtojnë nga 15 km. deri në Kamenicë.

21.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të investohet në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.
- Të mundësohet nga komuna që kompanitë që bëjnë investime të punësojnë banorët, për punë sezonale.
- Të përfshihen të gjitha lagjet e fshatit në projektet që implementohen. Në shumë raste investimet bëhen vetëm në një lagje të fshatit.
- Të vendoset ndriçimi publik.
- Të ndërtohet një fushë e mbyllur sportive, e cila do të mund të shfrytëzohej nga dy komunitetet si dhe nga 10 fshatra tjerë përreth.
- Të largohen ndërtesat e vjetra, të papërdorshme nga oborri i shkollës. Këto ndërtesa paraqesin rrezik për nxënësit.
- Të mundësohet një linjë transporti për Kamenicë dhe Gjilan.



Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Novobërdës në punëtorinë e mbajtur nga ATRC

22. FSHATI PARALLOVË

22.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Parallovë ka 80 familje me rreth 250 banorë. Infrastruktura rrugore në fshat nuk është e mirë. Vetëm një rrugë e fshatit, rreth 2 km. është e asfaltuar. Fshati nuk është i lidhur me rrjetin e kanalizimit, megjithatë për shkak të pozicionit të fshatit është shumë vështirë të rregullohet ky rrjet. Uji në fshat sigurohet me ramje të lirë, por gypat e ujit janë shumë të vjetër.

Fshati ka një shkollë, e cila është renovuar kohët e fundit. Renovimi i shkollës ka qenë një nga kërkesat e banorëve, të paraqitura në vitin 2013.

22.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të rregullohen rrugët në fshat.
- Të ndërrohen gypat e ujit (të ndërtohet një sistem për lagje veç e veç).
- Të ndërtohet një ambulantë.
- Të bëhet pastrimi i lumit.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në lagje të fshatit.
- Të bëhet ndërrimi rrjetit elektrik i tensionit të ulët.
- Të investohet në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

23. FSHATI KORETISHT

23.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Koretisht është i tipit të grumbulluar edhe me plan zhvillimor komunal është paraparë si vendbanim urban. Problemi kryesor i banorëve të fshatit është mungesa e menaxhimit adekuat të rrjetit të ujësjellësit. Ashtu si edhe në fshatrat tjerë, në mungesë të një kompanie publike, komuna merret me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit.

23.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të gjindet zgjidhja për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit.
- Të monitorohet nga komuna çdo investim i bërë dhe të përfshihen qytetarët në këtë proces.

- Të investohet në infrastrukturën rrugore: Të asfaltohen rrugët në të gjitha lagjet e fshatit dhe të rregullohen trotuaret.
- Të investohet në rregullimin e objektit të shkollës.
- Të rregullohen shtyllat elektrike të tensionit të ulët.
- Të investohet në sektorin e bujqësisë.
- Të vendoset rrethoja në varrezat e fshatit.
- Të rregullohet ndriçimi publik.



Konferenca regjionale e organizuar nga ATRC

24. FSHATI PASJAK

24.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Pasjak ka 4 lagje dhe rreth 230 shtëpi. Komuna e Novobërdës para disa vitesh ka bërë disa investime në rregullimin e infrastrukturës rrugore. Megjithatë, në tri lagjet e reja të fshatit nuk janë bërë investime. Veç rrugës kryesore, e cila është asfaltuar, në këto tri lagje nuk janë rregulluar rrugët lokale si dhe nuk janë vendosur rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit.

Pjesa tjetër e fshatit edhe pse është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit, banorët kanë probleme me furnizimin me ujë. Rrjeti i ujësjellësit në fshat është i përbashkët me fshatin Koretisht dhe për shkak të mos pageses së energjisë elektrike ky rrjet nuk është duke funksionuar.

Fshati ka një Zyre të vendit, e cila ofron shërbime për banorët. Në fshatin Pasjak para disa vitesh ka filluar ndërtimi i shkollës fillore, por akoma nuk ka përfunduar. Nxënësit janë duke zhvilluar mësimin në objektin e vjetër të shkollës, i cili është në gjendje shumë të keqe. Në këtë shkollë vijojnë mësimin mbi 380 nxënës.

Në fshatin Pasjak para disa vitesh ka filluar ndërtimi i objektit të burgut, megjithatë banorët kanë patur disa mosmarrëveshje rreth rrjetit të kanalizimit. Ata kanë kërkuar që rrjeti i kanalizimit të ndërtohet si duhet dhe t' mos u shkaktoj probleme banorëve.

24.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit në lagjet e reja.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit në lagjet e reja.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të asfaltohen rrugët në lagjet e reja; Të ndërtohet trotuari në tri lagjet e reja; Të asfaltohet rruga Pasjak-Koretisht.
- Të rregullohet parku i fshatit. Hapsira për rregullimin e parkut është pranë shkollës.
- Të funksionalizohet rrjeti i ujësjellësit.



Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Novobërdës dhe anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve në punëtorinë e mbajtur nga ATRC

25. FSHATRAT MAKRESH I ULËT DHE DRAGANC

25.1 Pasqyra e përgjithshme

Fshati Makresh i ulët dhe Dragancë kanë gjithsej 16 shtëpi. Banorët e dy fshatrave ballafaqohen me probleme të shumta, si mosrregullimi i rrugëve, mosfunksionimi i rrjetit të ujësjellësit, mungesa e rrjetit të kanalizimit, etj.

Para disa vitesh Komuna kishte bërë disa investime, sidomos në rregullimin e rrugëve, por nga viti 2010 nuk është bërë asnjë investim. Fshatrat kanë dy rrugë, por në veçanti rruga kryesore është në gjendje shumë të keqe. Banorët nuk janë pajtuar as të bëhet emërimi i rrugëve, derisa nuk rregullohen ato.

Komuna gjithashtu ka investuar në vendosjen e rrjetit të ujësjellësit, por ky rrjet nuk funksionon si duhet dhe nuk ka përfunduar. Kurse, rrjeti i kanalizimit nuk është vendosur fare në fshat.

Fshati ka një shkollë fillore, e cila është e vjetër. Banorët kërkojnë që të ndërtohet një shkollë me disa klasë në qendër të lagjes, meqë shkolla ekzistuese është në largësi prej 2 km e gjysëm dhe përreth shkollës së vjetër nuk ka shtëpi.

Problem tjetër i banorëve është edhe mosndërtimi i shtëpive të dëmtuara nga lufta. Disa nga banorët, shtëpitë e të cilëve janë dëmtuar, janë zhvendosur nga fshati, kurse katër familje jetojnë pa shtëpi.

25.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të ndërtohet një shkollë me disa klasë në qendër të lagjes.
- Të investohet në rregullimin e infrastrukturës rrugore: Të bëhet rregullimi i rrugës deri të shkolla fillore (rruga Makresh i epërm-Makresh i poshtëm); Të bëhet vazhdimi i asfaltimit të rrugës Dragancë, në të dy pjesët.
- Të rregullohet rrjeti elektrik dhe ndërrimi i trafos elektrike.
- Të rindërtohen shtëpitë e dëmtuara nga lufta.

26. FSHATI KUFCË E EPËRME

26.1 Pasqyra e përgjithshme

Infrastruktura rrugore në fshatin Kufcë e epërme nuk është e mirë. Rruga kryesore por edhe rrugët e lagjeve në fshat nuk janë të rregulluara. Gjithashtu, banorët kanë probleme me rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Edhe pse rrjeti i kanalizimit është vendosur në fshat, kapakët nuk janë në gjendje të mirë. Banorët e fshatit Kufcë e epërme ballafaqohen edhe me mungesën e transportit publik.

26.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit.
- Të rregullohet rrjeti i kanalizimit.
- Të investohet në infrastrukturën rrugore: Të rregullohet rruga kryesore; Të rregullohen rrugët në lagje; Të ndërtohet trotuari në rrugën kryesore; Të bëhet asfaltimi i rrugës Kufcë-Stanishor; Të asfaltohet rruga Kufcë-Kosaq.
- Të vendoset ndriçimi publik.
- Të sigurohet transporti publik.





Konferenca regjionale e organizuar nga ATRC

27. FSHATRAT BUSHINCË, TIRINCË DHE MIGANOVÇ

27.1 Pasqyra e përgjithshme

Ndër problemet kryesore të banorëve është mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe e kanalizimit. Asnjë nga tre fshatrat nuk kanë rrjet të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Problem tjetër i banorëve është mosvazhdimi i asfaltimit të rrugës. Kjo rrugë, një pjesë e së cilës ka qenë e asfaltuar, lidh Komunën e Novobërdës me tri fshatrat. Megjithatë, komuna ka asfaltuar rrugën Miganovc dhe lagjen Zmijarnovci, që ka qenë një nga kërkesat e banorëve të paraqitura në vitin 2013.

Fshati ka një shkollë fillore, e cila është ndërtuar para disa vitesh. Problem për banorët paraqesin edhe shtyllat elektrike, të cilat janë shumë të vjetra. Banorët, në veçanti gjatë motit të keq, janë të rrezikuar nga shtyllat elektrike.

27.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit.
- Të vendoset rrjeti i kanalizimit.
- Të investohet në infrastrukturën rrugore: Të vazhdohet asfaltimi i rrugës kryesore, e cila i lidh tri fshatrat me Komunën e Novobërdës; Të bëhet rregullimi i rrugës në lagjen e Oranëve.
- Të ndërrohen shtyllat elektrike.

28. FSHATI MAKRESH I EPËRM

28.1 Pasqyra e përgjithshme

Infrastruktura rrugore në fshat nuk është e mirë, pasi asnjë nga rrugët e fshatit nuk është rregulluar dhe madje nuk është punuar as në rrafshimin e tyre. Gjithashtu, fshati Makresh i epërm nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit.

Veç infrastrukturës jo të mirë rrugore dhe mungesës së rrjetit të ujësjellësit, banorët kanë probleme edhe me deponinë e mbeturinave, e cila ndodhet në fshat. Banorët kanë probleme edhe me furnizimin me energji elektrike, sidomos gjatë reshjeve. Fshati ka një shkollë, megjithatë, edhe pse është renovuar para disa vitesh, kjo shkollë nuk është në gjendje të mirë. Fshati ka një ambulantë e cila është renovuar në vitin 2013 nga komuna.

28.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të vendoset rrjeti i ujësjellësit.
- Të investohet në rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve.
- Të përmirësohet furnizimi me energji elektrike.
- Të rregullohet këndi i lojërave për fëmijë.

29. FSHATRA Bolevc dhe Carevc

29.1 Pasqyra e përgjithshme

Infrastruktura rrugore në fshatrat Bolevc dhe Carevc nuk është e mirë. Rrugët në fshat janë të shtruara me zhavorr dhe asnjë nga to nuk është asfaltuar.

Fshati nuk është i lidhur me rrjetin e ujësjellësit. Problem tjetër i banorëve është edhe furnizimi jo i mirë me energji elektrike, sidomos gjatë reshjeve.

Fshati ka një shkollë dhe një ambulantë. Shkolla në fshat është ndërtuar në vitin 2012, megjithatë në shkollë nuk është rregulluar rrjeti i ujësjellësit dhe ai i kanalizimit. Gjithashtu, kulmi i shkollës nuk është rregulluar mirë dhe menjëherë pas një viti ka filluar të depërtoj uji gjatë reshjeve.

29.2 Rekomandimet e banorëve:

- Të investohet në rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve.
- Të rregullohet rrjeti i ujësjellësit në dy fshatrat dhe në shkollë.
- Të përmirësohet furnizimi me energji elektrike.
- Të bëhet renovimi i shkollës në Carevc.
- Të ndërtohet fusha sportive në shkollën fillore në Carevc.

ATRC falenderon Komunën e Novobërdës, në veçanti Kryetarin e Komunës, Kryesuesin dhe anëtarët e kuvendit komunal, për përkrahjen gjatë implementimit të aktiviteteve në terren, si dhe anëtarët e Komitetit konsultativ të qytetarëve, përfaqësuesit e Këshillave Lokale dhe qytetarët, të cilët kontribuan në përpilimin e këtij dokumenti.

Informata shtesë

- Prioritetet e banorëve të komunës së Novobërdës, të përmbledhura dhe të publikuara në këtë dokument, janë mbledhur kryesisht gjatë periudhës maj - qershor 2015.
- Pjesa e parë rreth informatave të përgjithshme për komunën është bazuar në web faqen e komunës.

Përkrahur nga:



Implementuar nga:



Advocacy Training and Resource Center

Rr. Gazmend Zajmi, Nr. 20

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel/fax: +381 38 244 810

info@advocacy-center.org

www.advocacy-center.org

